



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 25, datë 24.04.2026

P Ë R

REFUZIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“HILLSIDE RETREAT 001- KOMPLEKS ME BANESA INDIVIDUALE 1, 2, 3 DHE 4 KAT MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË DHE PISHINË, QENDËR REHABILITIMI PËR TRAJTIMIN E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 1, 2 DHE 3 KAT MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË DHE PISHINË DHE KOMPLEKS HOTELERIE ME 5 KAT MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE PRANË RRUGËS “PETI”, BASHKIA TIRANË, ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË “ARLIS NDËRTIM” SH.P.K.

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenit 25 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e Lejes së Ndërtimit për objektin:“Hillside retreat 001- kompleks me banesa individuale 1, 2, 3 dhe 4 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë dhe pishinë, qendër rehabilitimi për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara 1, 2 dhe 3 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë dhe pishinë dhe kompleks hotelerie me 5 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje pranë Rrugës “Peti”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Arlis Ndërtim” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij Vendimi, lejohet ankim nga pala e interesuar, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Ligj Nr. 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 29/04 2026